**VENDIM**
**Nr.793, datë 29.11.2007**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KONTINGJENCËS, TË MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin "Sigurimi shoqëror", artikulli 604 "Të tjera transferta korrente, të brendshme", t'i shtohet fondi prej 1 000 000 000 (një mijë milionë) lekësh, nga fondi i kontingjencës, i miratuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2007.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**